



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06

Vendosi: Gjykatësi i procedurës paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 26 tetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: *Publik*

Versioni i redaktuar publik i

Vendimit për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenet 39(3), 53, 54, dhe 55 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 31, 32, 33, 37, 39, 62, dhe 208(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 prill 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) parashtroi për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, së bashku me materialin provues në mbështetje të pretendimeve faktike dhe një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e çdo prove me secilën akuzë.²
2. Më 28 maj 2020, ZPS-ja kërkoi ndër të tjera që gjykatësi i procedurës paraprake të autorizojë kontrollim dhe sekuestrim në lidhje me vetë Hashim Thaçin (“z. Thaçi”), vendin e arrestimit të tij, dhe shtëpitë e banimit, zyrat dhe automjetet e z. Thaçi.³
3. Më 2 korrik 2020, gjykatësi i procedurës paraprake urdhëroi ZPS-në që deri më 24 korrik 2020 të dorëzonte për protokollim një aktakuzë të rishikuar.⁴
4. Më 24 korrik 2020, ZPS-ja parashtroi aktakuzën e rishikuar për konfirmim (“Aktakuza e Rishikuar”).⁵

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim*, 24 prill 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-06, F00005, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë për lëshimin e fletarrestimeve dhe urdhrave në lidhje me to*, 28 maj 2020 (“Kërkesa”), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00010, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Urdhër Prokurorit të Specializuar në bazë të rregullës 86(4) të Rregullores*, 2 korrik 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00011, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për konfirmim*, 24 korrik 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

5. Më 11 shtator 2020, gjykatësi i procedurës paraprake urdhëroi ZPS-në që deri më 30 shtator 2020 të dorëzonte, ndër të tjera, informacion në lidhje me adresën aktuale apo të fundit të ditur të z. Thaçi.⁶

6. Më 30 shtator 2020, ZPS-ja dorëzoi informacionin e kërkuar.⁷

7. Më 19 tetor 2020, gjykatësi i procedurës paraprake lëshoi një urdhër në të cilin caktohej data e synuar për nxjerrjen e vendimit mbi Aktakuzën e Rishikuar.⁸

8. Më 26 tetor 2020, gjykatësi i procedurës paraprake nxori vendimin për konfirmimin e Aktakuzës së Rishikuar ("Vendimi i Konfirmimit")⁹ dhe lëshoi fletarrestim për z. Thaçi.¹⁰

II. PARASHTRIMET

9. Krahas lëshimit të fletarrestimit për z. Thaçi dhe urdhrit përkatës për transferimin e tij, ZPS-ja kërkon ndër të tjera që gjykatësi i procedurës paraprake të autorizojë kërkesën e saj për kontrollim dhe sekuestrim.¹¹ ZPS-ja kërkon që gjykatësi i procedurës paraprake të autorizojë ZPS-në dhe/ose autoritetet zbatuese të fletarrestimit, që në bashkëpunim me ZPS-në: (a) të kontrollojnë z. Thaçi, vendin e arrestimit të tij, si dhe shtëpitë e banimit, zyrat dhe automjetet e z. Thaçi; dhe (b) të sekuestrojnë prova që besohet se janë përdorur në, janë në lidhje me, ose mund të jenë të rëndësishme për krimet e paraqitura në aktakuzë, përpjekjet e kohëve të

⁶ KSC-BC-2020-06, F00015, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Urdhër Prokurorit të Specializuar për parashtrime plotësuese*, 11 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00019, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime plotësuese në bazë të urdhrit KSC-BC-2020-06/F00015*, 30 shtator 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcën 1 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00023, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Urdhër për caktimin e datës së synuar për një vendim sipas nenit 39(2)*, 19 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Vendim për konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00027/A01, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Fletarrestim për Hashim Thaçin*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

¹¹ Kërkesa, para. 2, 42, 60(b).

fundit për ndërhyrje në administrimin e drejtësisë, dhe [REDAKTUAR] (“kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar”).¹² Në veçanti, ZPS-ja kërkon, ndër të tjera, prova që lidhen me veprimtarinë e z. Thaçi midis viteve 1998 dhe 1999, marrëdhëniet ose ndërveprimet e tij me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”) dhe/ose Qeverinë e Përkohshme të Kosovës (“QPK”) ose me anëtarë të tyre, apo me viktimë, dëshmitarë ose bashkëkryes të pretenduar.¹³ ZPS-ja vë në dukje se ndër sendet që do të sekuestrohen mund të përfshihen: shënime nga kontakte apo mbledhje, të dhëna financiare ose pronësore, ditarë, regjistra, vendime, fotografi, videoincizime dhe audioincizime, urdhra, udhëzime, direktiva, raporte, politika, protokolle apo rregullore, si dhe kompjuterë, telefona dhe pajisje të tjera që logjikisht mund të pritet se përmbajnë prova relevante.¹⁴

10. ZPS-ja parashtrohet se ekziston dyshim i bazuar se z. Thaçi ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, si dhe dyshim i bazuar se ai mund të ketë me vete, apo në shtëpitë e banimit, zyrat ose automjetet e tij, prova të domosdoshme për hetimin.¹⁵

11. ZPS-ja parashtrohet gjithashtu se, duke mbajtur parasysh rrezikun e ndërhyrjes dhe pengimit,¹⁶ çfarëdo provash që posedon z. Thaçi nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër dhe kontrollimi e sekuestrimi i kërkuar janë e vetmja masë për sigurimin e tyre për nevojat e hetimit.¹⁷

12. ZPS-ja parashtrohet se cenimi që do t’u shkaktohej të drejtave të z. Thaçi për pronë dhe privatësi është proporcional me qëllimin legjitim të hetimit dhe nuk eliminon thelbin e atyre të drejtave.¹⁸

¹² Kërkesa, para. 42.

¹³ Kërkesa, para. 42(b).

¹⁴ Kërkesa, para. 42(b).

¹⁵ Kërkesa, para. 43.

¹⁶ Kërkesa, para. 34-38, 43.

¹⁷ Kërkesa, para. 43.

¹⁸ Kërkesa, para. 44.

13. Së fundi, ZPS-ja kërkon autorizim për mbajtjen në ruajtje të provave të sekuestruara për aq kohë sa është e nevojshme për vlerësimin e tyre, dhe në qoftë se provat gjykohe të relevante, afati i autorizimit të zgjatet për aq kohë sa është e nevojshme për hetimet dhe procedurat gjyqësore.¹⁹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

14. Në përputhje me nenin 35(2)(b) të Ligjit, Prokurori i Specializuar mund të mbledhë dhe shqyrtojë informacion dhe prova.

15. Sipas rregullave 31 dhe 37 të Rregullores, kontrollimi i një personi, i pronës së tij ose i vendndodhjeve apo objekteve të tjera, si dhe sekuestrimi i çfarëdo prove të gjetur gjatë kontrollimit, mund të autorizohet në qoftë se:

- (a) ka pritshmëri të arsyeshme për privatësinë në lidhje me vendndodhjet që do të kontrollohen dhe sendet që do të sekuestrohen;²⁰
- (b) lidhur me kontrollimin e vendndodhjeve dhe objekteve, ekziston dyshim i bazuar se (i) personi ka kryer, është duke kryer, ose është në prag të kryerjes së një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, dhe (ii) kontrollimi do të rezultojë, ndër të tjera, në zbulimin dhe sekuestrimin e provave të domosdoshme për hetimin.²¹ Lidhur me kontrollimin e personit, ekziston dyshim i bazuar se kontrollimi do të rezultojë në zbulimin e provave të një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe sekuestrimin e tyre;²²

¹⁹ Kërkesa, para. 45.

²⁰ Rregulla 37(2) e Rregullores. *Shih gjithashtu* KSC-CC-PR-2017-03, F00006, Dhoma e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 29 maj 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Aktvendimi i Dhomës së Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara të Kosovës i datës 28 qershor 2017")*, 28 qershor 2017, para. 69.

²¹ Rregulla 37(2)(a) e Rregullores.

²² Rregulla 37(3) e Rregullores.

- (c) kontrollimi është i domosdoshëm për hetimin;²³
- (d) masa hetimore është e pashmangshme, d.m.th. në rrethanat konkrete provat nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër dhe kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar duket se janë e vetmja masë e efektshme për nevojat e hetimit;²⁴ dhe
- (e) cenimi i shkaktuar mbi të drejtën e personit për integritet personal, privatësi apo pronë, është proporcional me qëllimin legjitim të hetimit dhe nuk eliminon thelbin e të drejtës së garantuar.²⁵

16. Sipas rregullës 37(4) të Rregullores, vendimi për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit përmban: (a) orarin, kohëzgjatjen dhe shkallën e kontrollimit dhe sekuestrimit, duke përfshirë të dhëna për personin ose pronën, vendndodhjen, mjediset ose objektin në lidhje me të cilat autorizohet masa; dhe (b) procedurën e raportimit në lidhje me zbatimin e masës së autorizuar dhe materialin e sekuestruar, në përputhje me rregullën 31(2) të Rregullores.

17. Bazuar në rregullën 39(1) dhe (2) të Rregullores, kontrollimi dhe sekuestrimi duhet të kryhen në prani të personit përkatës, përveçse kur ky person nuk mund të gjendet ose refuzon të jetë i pranishëm gjatë kryerjes së kontrollimit, dhe kur çdo vonesë në kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit do të rrezikonte hetimin apo sigurinë ose pronën e një dëshmitari, viktime apo personi tjetër të rrezikuar. Prokurori i Specializuar gjithashtu duhet: (a) t'i japë personit përkatës vendimin që autorizon kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit; (b) ta informojë personin në fjalë për të drejtat e tij; (c) të sigurojë praninë e mbrojtësit të personit, përveçse kur personi heq dorë nga ushtrimi i kësaj të drejte, apo nuk është e arsyeshme të pritët për praninë e

²³ Rregulla 31(1)(b) e Rregullores.

²⁴ Rregulla 37(1) e Rregullores. *Shih gjithashtu* Aktvendimi i Dhomës së Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara të Kosovës i datës 28 qershor 2017, para. 62-67.

²⁵ Rregulla 31(1)(c) e Rregullores.

mbrojtësit; dhe (d) të sigurojë praninë e një vëzhguesi të pavarur gjatë kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit.

18. Bazuar në rregullën 32(1) të Rregullores, çdo material i sekuestruar mbahet, ruhet dhe mbrohet në mënyrën e duhur. Paneli që autorizon sekuestrimin saktëson: (a) procedurën dhe masat paraprake për ruajtjen, mbrojtjen dhe transferimin e materialit të sekuestruar; (b) kohëzgjatjen e mbajtjes së materialit të sekuestruar; dhe (c) udhëzimet dhe afatet për kthimin ose asgjësimin e materialit të sekuestruar.

19. Sipas rregullës 62 të Rregullores, gjatë ushtrimit të detyrave të veta, Prokurori i Specializuar, ndër të tjera, merr masat për mbrojtjen dhe respektimin e duhur të viktimave dhe dëshmitarëve, si dhe të të drejtave themelore të të akuzuarve.

20. Neni 35(3) i Ligjit përcakton se policia në kuadër të ZPS-së ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që ka Policia e Kosovës në bazë të legjislacionit të Kosovës. Në përputhje me nenin 53(1) të Ligjit, të gjitha subjektet dhe personat në Kosovë përmbushin pa vonesë të papërligjur çdo kërkesë për ndihmë, urdhër apo vendim të Dhomave të Specializuara. Bazuar në rregullën 202(2) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake mund të urdhërojë çfarëdo kushtesh që i gjykon të nevojshme, përfshirë në lidhje me konfidencialitetin dhe masat mbrojtëse. Këta urdhra përmbushen pa vonesë të papërligjur, në pajtim me nenin 53(1) të Ligjit dhe rregullën 202(3) të Rregullores.

21. Në përputhje me nenin 55 të Ligjit dhe rregullën 208(1) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake mund të kërkojë bashkëpunimin dhe ndihmën e një shteti të tretë nëse është e nevojshme për hetimin dhe ndjekjen penale të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

IV. DISKUTIM

A. KRITERET E KONTROLLIMIT DHE SEKUESTRIMIT

22. Kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar përfshijnë kontrollimin e z. Thaçi, të vendit të arrestimit, shtëpive të banimit, zyrave dhe automjeteve të tij. Gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se shtëpia e banimit, prona, përfshirë automjetet dhe zyrat e një personi, bartin në vetvete pritshmëri të arsyeshme për privatësi. Po kështu edhe vendi i arrestimit, megjithëse nuk është i ditur në këtë moment, mund të bartë në vetvete pritshmëri të arsyeshme për privatësi.²⁶ Për këto arsye janë të zbatueshme garancitë mbrojtëse të parapara në Ligj dhe Rregullore.

23. Në kontekstin e kontrollimit të shtëpisë/shtëpive të banimit, zyrës/zyrave, automjetit/automjeteve, dhe/ose vendit të arrestimit të z. Thaçi dhe sekuestrimit përkatës të sendeve, gjykatësi i procedurës paraprake rikujton konstatimet e tij në Vendimin e Konfirmimit se ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Thaçi ka kryer krime brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.²⁷ Po kështu, pasi ka shqyrtuar parashtrimet e Prokurorit të Specializuar dhe materialin e paraqitur në mbështetje të tyre,²⁸ gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar se z. Thaçi ka bërë përpjekje të ndërhyjë në punën hetimore të ZPS-së përmes ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve, çka përbën vepër penale në bazë të nenit 15(2) të Ligjit, e përfshirë gjithashtu brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara. Konkretisht, ekziston dyshim i bazuar se z. Thaçi, ndër të tjera, është përfshirë në pagesat që u ka bërë qeveria disa dëshmitarëve të mundshëm të ZPS-së,²⁹ [REDAKTUAR],³⁰ është interesuar për gjendjen familjare të një personi që do të intervistohet nga ZPS-ja, dhe pas kësaj, [REDAKTUAR] i ka ofruar atij personi përfitime të ndryshme në emër të

²⁶ *Shih* Aktvendimi i Dhomës së Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara të Kosovës i datës 28 qershor 2017, para. 69.

²⁷ Vendimi i Konfirmimit, para. 474, 478, 482, 491.

²⁸ Kërkesa, para. 8, 10-18 dhe referencat e përfshira aty; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 2-3; Shtojca 3 e Kërkesës, f. 8.

²⁹ Kërkesa, para. 10-11 dhe referencat e përfshira aty.

³⁰ Kërkesa, para. 12; Shtojca 1 e Kërkesës, f. 3-4.

z. Thaçi,³¹ si dhe ka punësuar individë të thirrur nga ZPS-ja në poste qeveritare pak pas lëshimit të fletëthirrjeve për ta.³² Gjykatësi i procedurës paraprake konstaton gjithashtu se, duke mbajtur parasysh sa më lart, ekziston dyshim i bazuar se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar në lidhje me vendet dhe sendet e lartpërmendura mund të rezultojë në prova ose informacion të domosdoshëm për hetimin e ZPS-së të krimeve të paraqitura në aktakuzë dhe veprave penale në bazë të nenit 15(2) të Ligjit, përfshirë për respektimin e të drejtave të viktimave. Gjykatësi i procedurës paraprake konstaton gjithashtu se, në bazë të sa më lart, ekziston dyshim i bazuar se prova dhe informacion i tillë mund të gjenden në shtëpinë/shtëpitë e banimit, zyrën/zyrat, automjetin/automjetet dhe/ose vendin e arrestimit të z. Thaçi. Në lidhje me kontrollimin e z. Thaçi, duke marrë parasysh pretendimet se ai ka kryer krime dhe vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton ekzistencën e dyshimit të bazuar se kontrollimi mund të rezultojë në gjetjen dhe sekuestrimin e provave në lidhje me ato krime dhe vepra penale. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar që përlligj kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar.

24. Për më tepër, duke marrë parasysh se në shtëpinë/shtëpitë e banimit, zyrën/zyrat, automjetin/automjetet, dhe/ose vendin e arrestimit të z. Thaçi mund të gjendet informacion i rëndësishëm në lidhje me akuzat e konfirmuara dhe veprat penale të pretenduara në bazë të nenit 15(2) të Ligjit, përfshirë informacion në lidhje me respektimin e të drejtave të viktimave, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar janë të domosdoshëm për hetimin e ZPS-së. Po kështu, kontrollimi i z. Thaçi është i domosdoshëm për arsye se gjatë arrestimit apo kontrollimit të mjediseve të tij, ai mund të orvatet të fshehë në trup prova të tilla. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se kontrollimi

³¹ Kërkesa, para. 15 dhe referencat e përfshira aty.

³² Kërkesa, para. 17 dhe referencat e përfshira aty; Shtojca 3 e Kërkesës, f. 8.

dhe sekuestrimi i kërkuar janë të domosdoshëm për hetimin prej ZPS-së të akuzave të konfirmuara, si dhe për çfarëdo procedurash në të ardhmen, përfshirë në lidhje me vepra penale në bazë të nenit 15(2) të Ligjit.

25. Për sa i përket kriterit të pashmangshmërisë, gjykatësi i procedurës paraprake thekson se z. Thaçi ka sulmuar publikisht mandatin e Dhomave të Specializuara dhe është përpjekur t'i delegitimojë ato,³³ dhe rikujton që ekziston dyshim i bazuar se ai ka bërë përpjekje të ndërhyjë në punën hetimore të ZPS-së përmes ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve. Është e arsyeshme të besohet se sulmet publike të tij ndaj Dhomave të Specializuara dhe gatishmëria e qartë e tij për të penguar procedurat përmes ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve, është shprehje e gatishmërisë së tij për të ndërhyrë në prova. Rrjedhimisht, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se çfarëdo provash ose informacioni që posedon z. Thaçi nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër dhe kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar në kuadër të arrestimit të tij mund të jenë e vetmja masë e efektshme për sigurimin e atyre provave apo atij informacioni.

26. Së fundi, në lidhje me proporcionalitetin e cenimit që do t'u shkaktohej të drejtave të z. Thaçi kundrejt qëllimit legjitim të hetimit, gjykatësi i procedurës paraprake mund të marrë parasysh, ndër të tjera, natyrën e rëndë të akuzave të konfirmuara³⁴ dhe të veprave penale të pretenduara në bazë të nenit 15(2) të Ligjit, kohëzgjatjen dhe shkallën e masave të kërkuara dhe garancitë mbrojtëse që do të zbatohen.³⁵ Qëllimi legjitim i hetimit është ndjekja penale e z. Thaçi për krimet për të cilat ai akuzohet dhe mbledhja e provave në lidhje me veprat penale të pretenduara në bazë të nenit 15(2) të Ligjit, si edhe respektimi i të drejtave të viktimave. Në lidhje me garancitë mbrojtëse që do të zbatohen, gjykatësi i procedurës paraprake mban parasysh faktin se, sikurse

³³ Kërkesa, para. 7; Shtojca 2 e Kërkesës, f. 2-8 (Letër e Hashim Thaçit drejtuar Majkëll Pompeos, e raportuar në *Gazeta Express*).

³⁴ Akuzat janë në lidhje me krimet kundër njerëzimit të përndjekjes, burgimit, veprimeve të tjera çnjerëzore, torturës, vrasjes së paligjshme, dhe zhdukjes me forcë të personave, dhe me krimet e luftës të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme, përkatësisht në shkelje të nenit 13(1) dhe nenit 14(1)(c) të Ligjit.

³⁵ Aktvendimi i Dhomës së Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara të Kosovës i datës 28 qershor 2017, para. 64.

mishërohet në rregullat 31-33 dhe 39 të Rregullores, ZPS-ja ka për detyrë të marrë masat e nevojshme në lidhje me të drejtat për integritet personal, privatësi ose pronë. Po aq i rëndësishëm është edhe zotimi i ZPS-së se do ta përshtatë kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar dhe/ose do t'u përcjellë informacionin dhe udhëzimet e nevojshme autoriteteve të tjera që mund të ndihmojnë në kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit, për të garantuar kryerjen e tyre në një mënyrë që përjashton informacion që nuk parashikohet të jetë i rëndësishëm dhe e cila është në përputhje me garancitë mbrojtëse të përcaktuara në rregullën 39 të Rregullores.³⁶ Rrjedhimisht, në qoftë se kryhen në përputhje me kushtet e përcaktuara në Rregullore dhe në këtë vendim, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar janë proporcionalë me qëllimin legjitim të hetimit.

27. Pasi ka konstatuar se janë përmbushur kriteret e lartpërmendura, gjykatësi i procedurës paraprake autorizon kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar meqenëse janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në rregullën 31 dhe rregullën 37 të Rregullores.

B. ORARI, KOHËZGJATJA DHE SHKALLA E KONTROLLIMIT DHE SEKUESTRIMIT

28. ZPS-ja nuk bën të ditur kohën e kryerjes së kontrollimit të z. Thaçi, të shtëpisë/shtëpive të banimit, zyrës/zyrave, automjetit/automjeteve dhe/ose të vendit të arrestimit të tij, dhe të sekuestrimit përkatës të sendeve. Sidoqoftë, është e qartë nga Kërkesa se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar do të ndodhin në kuadër të arrestimit të z. Thaçi. Duke baraspeshuar rëndësinë e faktorit kohë për veprimet hetimore dhe kohën që i nevojitet ZPS-së apo cilitdo autoriteti tjetër përkatës për organizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, pritshmërinë e arsyeshme të z. Thaçi për privatësi, si edhe nevojën për mbikëqyrje gjyqësore të zbatimit të këtyre masave, gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se për

³⁶ Kërkesa, para. 44.

kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar mjaftojnë 14 ditë nga dita e arrestimit të z. Thaçi.

29. Kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar duhet të kufizohen në prova ose informacion që besohet se janë përdorur në, janë në lidhje me, ose janë të rëndësishme për, akuzat e konfirmuara dhe veprat penale të pretenduara në bazë të nenit 15(2) të Ligjit, dhe për respektimin e të drejtave të viktimave. Kjo ka të bëjë në veçanti me prova që lidhen me veprimtarinë e z. Thaçi midis viteve 1998 dhe 1999, marrëdhëniet ose ndërveprimet e tij me UÇK-në dhe/ose QPK-në ose me anëtarë të tyre, apo me viktima, dëshmitarë ose bashkëkryes të pretenduar, dhe me çfarëdo prove tjetër që ka lidhje me respektimin e të drejtave të viktimave. Ndër sendet që do të sekuestrohen mund të përfshihen: shënime nga kontakte apo mbledhje, të dhëna financiare ose pronësore, ditarë, regjistra, vendime, fotografi, videoincizime dhe audioincizime, urdhra, udhëzime, direktiva, raporte, politika, protokolle apo rregullore, si dhe kompjuterë, telefona dhe pajisje të tjera që logjikisht mund të pritet se përmbajnë prova relevante.

C. RAPORTIMI PËR KONTROLLIMIN DHE SEKUESTRIMIN

30. Në përputhje me rregullat 31(2) dhe 37(4)(b) të Rregullores, ZPS-ja duhet të raportojë për zbatimin e masave të kërkuara. Duke marrë parasysh kohën e nevojshme për përgatitjen e një raporti pas zbatimit të masës së kërkuar, ZPS-ja duhet të paraqesë një raport brenda 14 ditësh nga përfundimi i kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, ose brenda 14 ditësh nga përfundimi i afatit 14-ditësh të përcaktuar për kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, në cilëndo datë të mëhershme. Raporti duhet të përmbajë: (a) datën, orën, kohëzgjatjen, vendndodhjen, shkallën dhe rrethanat e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar; dhe (b) përmbushjen e kriterëve të parapara në rregullën 39 të Rregullores. Nëse kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar, ose pjesë të tyre, do të kryhen në mungesë të z. Thaçi, raporti duhet të përmbajë gjithashtu

rrethanat e jashtëzakonshme që përlijin kryerjen e tyre, si dhe përmbushjen e garancive të tjera mbrojtëse, sikurse përcaktohen në paragrafin 36 më poshtë.

D. MBAJTJA, RUAJTJA DHE MBROJTJA E MATERIALIT TË SEKUESTRUAR

31. Gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se është e nevojshme që ZPS-ja të ruajë, mbrojë dhe transferojë materialin e sekuestruar në përputhje me procedurën standarde të kronologjisë së mbajtjes në ruajtje. Gjatë kësaj, ZPS-ja duhet të ndërmarrë masat e duhura për mbrojtjen e materialit të sekuestruar nga humbja, qasja e paqëllimshme ose e paautorizuar, ndryshimi, shpërndarja apo asgjësimi. Në raportin e vet, ZPS-ja informon gjykatësin e procedurës paraprake për procedurën dhe masat e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit të sekuestruar.

32. Gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se për vlerësimin e rëndësisë së materialit të sekuestruar mjafton një afat prej katër muajsh nga data e kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar. Në qoftë se konstatohet se materiali i sekuestruar është i rëndësishëm për hetimin apo për çfarëdo faze të procedurave në të ardhmen në lidhje me akuzat e konfirmuara ose me veprat penale të pretenduara në bazë të nenit 15(2) të Ligjit, ZPS-ja, në pajtim me rregullën 33(1)(b) të Rregullores, mund ta mbajë materialin deri kur ai pushon së qeni i rëndësishëm për qëllimin për të cilin është marrë. Në atë rast, materiali i sekuestruar duhet të kthehet ose asgjësohet në përputhje me rregullën 33(2)-(3) të Rregullores. Në qoftë se materiali i sekuestruar nuk lidhet me qëllimin e hetimit për të cilin është marrë dhe nuk është i rëndësishëm për hetimin e një vepre penale tjetër brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, materiali i sekuestruar duhet të kthehet ose asgjësohet menjëherë, në përputhje me rregullën 33(1)(a)(i) dhe (2)-(3) të Rregullores.

E. ZBATIMI DHE DORËZIMI I URDHRI TË KËRKUAR

33. Në qoftë se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar, ose pjesë të tyre, do të kryhen në Kosovë, gjykatësi i procedurës paraprake rikujton se, sipas nenit 35(3) të Ligjit, policia në kuadër të ZPS-së ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që ka policia e Kosovës në bazë të legjislacionit të Kosovës. Për këtë arsye, edhe ZPS-ja mund të konsiderohet “autoritet kompetent” brenda kuptimit të rregullës 49(1) të Rregullores, e aftë për zbatimin dhe dorëzimin e urdhrave të Dhomave të Specializuara, ndër të cilët edhe urdhri për kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar. Rrjedhimisht, gjykatësi i procedurës paraprake autorizon ZPS-në që të dorëzojë dhe zbatojë këtë vendim.³⁷ Nëse është e nevojshme, ZPS-ja mund ta dorëzojë dhe zbatojë vendimin në bashkëpunim me autoritetet kompetente në Kosovë.

34. Në qoftë se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar, ose pjesë të tyre, do të kryhen në një shtet të tretë, gjykatësi i procedurës paraprake, në përputhje me nenin 55 të Ligjit dhe rregullën 208(1) të Rregullores, kërkon nga autoritetet kompetente që këtë vendim ta dorëzojnë dhe zbatojnë në praninë e përfaqësuesve të ZPS-së.

35. ZPS-ja parashtron se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar mund të kryhen në mungesë të z. Thaçi dhe se ajo synon të ndalojë përkohësisht përdorimin e komunikimeve jo të domosdoshme në vendin e kryerjes së cilitdo kontrollimi dhe sekuestrimi.³⁸ Duke qenë se këto kushte ndikojnë në të drejtat e z. Thaçi gjatë kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, gjykatësi i procedurës paraprake e konsideron të nevojshme të vlerësojë dhe, sipas nevojës, t'i përfshijë këto kushte në këtë vendim.

36. Sikurse u theksua më lart, kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar do të kryhen në kuadër të arrestimit të z. Thaçi dhe brenda 14 ditësh. Në lidhje me këtë, gjykatësi i procedurës paraprake thekson se në bazë të nenit 41(5) të Ligjit dhe rregullës 50(1) të

³⁷ Me njoftimin e këtij vendimi Prokurorit të Specializuar, transmetimi quhet i kryer në përputhje me rregullën 49(1) të Rregullores.

³⁸ Kërkesa, poshtëshënimi 130.

Rregullores, çdo person të cilit i është hequr liria nga Dhomat e Specializuara ose në emër të tyre, transferohet dhe paraqitet pa vonesë para gjykatësit të Dhomave të Specializuara. Gjykatësi i procedurës paraprake gjithashtu thekson statusin e z. Thaçi si person i njohur për shkak të pozitive të tij të kaluara dhe të tashme³⁹ si edhe mundësinë e shqetësimeve më të mëdha për sigurinë që mund të sjellë arrestimi i tij brenda Kosovës apo në një shtet tjetër. Në lidhje me sa më lart, kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar, ose pjesë të tyre, mund të kryhen në raste të jashtëzakonshme në mungesë të z. Thaçi, në qoftë se ZPS-ja mund të demonstrojë se kjo është absolutisht e domosdoshme për garantimin e sigurisë së vetë z. Thaçi, të së drejtës së tij për t'u paraqitur pa vonesë para gjykatësit të procedurës paraprake, dhe/ose për ruajtjen e provave dhe të integritetit të hetimit. Në rrethana të tilla, z. Thaçi ka të drejtën të caktojë një përfaqësues që të jetë i pranishëm gjatë kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, ose pjesëve të tyre, së bashku me një vëzhgues të pavarur dhe mbrojtësin e z. Thaçi, përveç nëse zbatohet përjashtimi i paraparë në rregullën 39(1)(c) të Rregullores.

37. Për më tepër, pavarësisht nëse z. Thaçi do të jetë i pranishëm gjatë kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se për të siguruar integritetin e hetimit dhe të procedurave në lidhje me të, ZPS-ja ose autoritetet që e ndihmojnë atë në zbatimin e kësaj mase, mund t'ia ndalojnë atij përkohësisht përdorimin e mjeteve jo të domosdoshme të komunikimit elektronik gjatë gjithë kohës së kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, ose të pjesëve të tyre.

V. VENDIM

38. Për arsyet e lartpërmendura, në lidhje me **z. Hashim Thaçi**, i lindur më 24 prill 1968, me shtetësi kosovare (numri personal: [REDAKTUAR]), me adresë të fundit banimi të ditur: [REDAKTUAR], komuna e Graçanicës, Kosovë, dhe me adresë të

³⁹ Aktakuza e Rishikuar, para.2-3.

fundit pune të ditur: Zyra e Presidentit, Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Rruga Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Kosovë, gjykatësi i procedurës paraprake:

- a. **AUTORIZON** kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar në lidhje me kontrollimin e z. Thaçi, të vendit të arrestimit dhe të shtëpisë/shtëpive të banimit, zyrës/zyrave, dhe automjetit/automjeteve të tij, si dhe sekuestrimin e çfarëdo provash ose informacioni që besohet se janë përdorur në, kanë lidhje me ose mund të jenë të rëndësishme për hetimin ose për cilëndo fazë të procedurave në të ardhmen lidhur me akuzat e konfirmuara ose me veprat penale të pretenduara në bazë të nenit 15(2) të Ligjit, përfshirë respektimin e të drejtave të viktimave, sikurse përcaktohet më me hollësi në paragrafin 29 të këtij vendimi;
- b. **AUTORIZON** që, pas demonstrimit të ekzistencës së rrethanave të jashtëzakonshme, kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar, ose pjesë të tyre, të kryhen në mungesë të z. Thaçi në varësi të garancive mbrojtëse shtesë dhe sikurse përcaktohet më me hollësi në paragrafin 36 më lart;
- c. **AUTORIZON** ZPS-në ose autoritetet që e ndihmojnë atë në zbatimin e urdhrit, që t'ia ndalojnë përkohësisht z. Thaçi përdorimin e mjeteve jo të domosdoshme të komunikimit elektronik, me përjashtim të komunikimit të tij konfidencial me mbrojtësin, gjatë gjithë kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, ose pjesëve të tyre; dhe
- d. **AUTORIZON** ZPS-në që këtë vendim t'ua bëjë të ditur, kur është e përshtatshme dhe e nevojshme, ndër të tjera edhe autoriteteve që kryejnë kontrollimin dhe autorizimin e kërkuar.

39. Në qoftë se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar, ose pjesë të tyre, do të kryhen në Kosovë, gjykatësi i procedurës paraprake **AUTORIZON** ZPS-në që të dorëzojë dhe zbatojë këtë urdhër në përputhje me paragrafët 28-29 dhe 33 më lart dhe rregullën 39 të Rregullores.

40. Në qoftë se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar, ose pjesë të tyre, do të kryhen në një shtet të tretë, gjykatësi i procedurës paraprahe:

- a. **URDHËRON** Administratoren që këtë vendim t'ua transmetojë autoriteteve kompetente për dorëzim dhe zbatim;
- b. **URDHËRON** ZPS-në të këshillohet me Administratoren lidhur me përgatitjet e nevojshme praktike për dorëzimin dhe zbatimin e këtij vendimi;
- c. **KËRKON** prej autoriteteve kompetente që të kryejnë kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar në praninë e një përfaqësuesi të ZPS-së dhe duke iu përmbajtur kushteve të mëposhtme, në qoftë se këto kushte nuk cenojnë legjislacionin shtetëror në fuqi:
 - i. kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar të përfundojnë brenda 14 ditësh nga arrestimi i z. Thaçi;
 - ii. t'i lejohet z. Thaçi ose përfaqësuesit të zgjedhur prej tij, sipas rastit, mbrojtësit të tij (përveç nëse zbatohet rregulla 39(1)(c) e Rregullores) dhe një vëzhguesi të pavarur, që të jenë të pranishëm gjatë kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar;
 - iii. zotit Thaçi t'i ndalohet përkohësisht përdorimi i mjeteve jo të domosdoshme të komunikimit elektronik, me përjashtim të komunikimit të tij konfidencial me mbrojtësin, gjatë gjithë kohës së kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar;
 - iv. t'i lejohet përfaqësuesit të pranishëm të ZPS-së që të shënojnë orën, kohëzgjatjen, shkallën dhe hollësi të tjera lidhur me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të përgatisë listën e inventarit me përshkrim të hollësishëm dhe informacion për çdo send të sekuestruar; dhe
 - v. materiali i sekuestruar, i cili mund të përfshijë shënime nga kontakte apo mbledhje, të dhëna financiare ose pronësore, ditarë,

regjistra, vendime, fotografi, videoincizime dhe audioincizime, urdhra, udhëzime, direktiva, raporte, politika, protokolle apo rregullore, si dhe kompjuterë, telefona dhe pajisje të tjera që logjikisht mund të pritet se përmbajnë prova ose informacion relevant, t'i transferohet ZPS-së dhe të mbahet, ruhet e mbrohet prej ZPS-së;

- d. **KËRKON** prej autoriteteve kompetente që të informojnë përfaqësuesin e ZPS-së të pranishëm gjatë kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar për çdo vështirësi ose pengesë teknike apo logjistike në zbatimin e këtij vendimi; dhe
- e. **KËRKON** prej autoriteteve kompetente që t'i trajtojnë kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar si konfidencialë, dhe ekzistencën dhe përmbajtjen e këtij vendimi t'ua bëjnë të ditur vetëm atyre subjekteve dhe personave përfshirja e të cilëve është absolutisht e domosdoshme për kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar.

41. Pavarësisht se ku do të kryhen kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar, ose pjesë të tyre, gjykatësi i procedurës paraprake:

- a. **URDHËRON** ZPS-në të raportojë mbi kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar brenda 14 ditësh nga përfundimi i tyre, ose brenda 14 ditësh nga përfundimi i afatit 14-ditësh të përcaktuar për kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit, në cilëndo datë të mëhershme, në përputhje me paragrafin 30 të këtij vendimi;
- b. **URDHËRON** ZPS-në të mbajë, ruajë dhe mbrojë materialin e sekuestruar dhe të raportojë mbi procedurën dhe masat paraprake për ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit, në përputhje me paragrafin 31 të këtij vendimi; dhe
- c. **URDHËRON** ZPS-në të vlerësojë rëndësinë e materialit të sekuestruar brenda katër muajsh nga data e kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit

të kërkuar si dhe të mbajë në ruajtje, kthejë ose asgjësojë materialin e sekuestruar sikurse përcaktohet në rregullën 33 të rregullores, në përputhje me paragrafin 32 të këtij vendimi.

/nënshkrim/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i procedurës paraprake

E hënë, 26 tetor 2020

Në Hagë, Holandë.